

TË DHËNAT ADMINISTRATIVE MBI PAGAT

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Menaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Kohërendja dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Tregut të Punës, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real
1.3. Personi i kontaktit	Julinda Hackaj
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Tregut të Punës
1.5. Adresa postare	Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	jhackaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	11.03.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	11.03.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	11.03.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Të dhënat Administrative mbi Pagat përmbajnë të dhëna të detajuara për nivelin e pagave shpërndarjes dhe ndryshimit të tyre përgjatë tremujorëve dhe një viti. Këto statistika ofrojnë një mundësi për të krahasuar pagat në industri të ndryshme dhe për grup-profesione të ndryshme. Rritja reale e pagave dhe hendeku gjinor i pagave janë gjithashtu të një rëndësie të veçantë për monitorimin e treguesve ekonomikë dhe që përdoren nga politikë-bërësit, punëdhënësit dhe sindikatat për të vlerësuar kushtet e kërkesës dhe të ofertës për punë.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Për klasifikimin dhe kodifikimin e Statistikave të Pagave përdoren: - Grup-profesionet sipas Klasifikimi - Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev.2
3.3. Mbulimi i sektorit	Ky informacion mbulon të dhëna mbi: Hendekun gjinor të pagës mesatar mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike;

	2. Hendekun gjinor të pagës mesatar mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grupo-profesioneve; 3. Pagën mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grupo- profesioneve dhe gjinisë; 4. Pagën mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë; 5. Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë dhe paga minimale e miratuar, Tr.4.2018-Tr.4.2024; 6. Shpërndarja e të punësuarve kontribues sipas intervaleve të pagës mesatare mujore bruto.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer në një muaj. Ajo përbëhet nga: a. Paga bazë për punën e kryer b. Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese c. Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë d. Shtesa mbi pagë për vështirësi në punë e. Shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.) f. Shpërblime Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat. Paga minimale mujore është paga më e ulët e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kontribues me pagë në sektorin e Bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit konsiderohen të gjithë të punësuarit me pagë të deklaruar nga fermat/ ndërmarrjet bujqësore të rregjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Ndryshimi i pagës reale shpreh raportin e ndryshimit mesatar të pagave dhe çmimeve gjatë periudhës që shqyrtohet. Paga minimale mujore është paga më e ulët e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e Të dhënave Administrative mbi Pagat në Shqipëri është paga minimale zyrtare dhe paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet numrit të të punësuarve në sektorin privat bujqësor, jobujqësor, të punësuarit në sektorin shtetëror në aktivitetet sipas NVE Rev.2 nga seksioni A në U: A. Sektori i Bujqësisë, Silvikulturës dhe Peshkimit; - Industrië nxjerrëse; C. Industria përpunuese; D. Energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar; E. Furnizimit me aktivitetet e kanalizimeve, menaxhimit të mbetjeve dhe riparimit ujë; F. Ndërtimit; G. Tregtisë me shumicë dhe me pakicë; riparimit të automjeteve dhe motorçikletave; H. Transportit dhe magazinimit;

	I. Aktiviteteve të akomodimit dhe shërbimit ushqimor; J. Informacionit dhe komunikacionit; K. Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit; L. Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme; M. Aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike; N. Aktiviteteve të shërbimeve administrative dhe mbështetëse; O. Administratës publike dhe mbrojtjes; Sigurimit social të detyrueshëm; P. Arsimit; Q. Shëndetësisë dhe aktiviteteve të punës sociale; R. Arteve, argëtimit dhe çlodhjes, S. Aktivitete të shërbimeve të tjera; T. Aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe U. Aktivitetet e organizatave dhe organeve ekstraterritoriale Dhe bazuar në grup profesionet sipas ISCO 08 përfshihen: 1. Manaxherët; 2. Specialistët me arsim të lartë (profesionistë); 3. Teknikët dhe specialistët në zbatim; 4. Nëpunësit; 5. Punonjësit e shitjeve dhe të shërbimeve; 6. Punonjësit e kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit; 7. Zejtarët, artizanët dhe profesionet e lidhura me to; 8. Punonjësit e montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve; 9. Punëtorësit (Profesione elementare); 10. Forcat e armatosura.
3.7. Zona e referencës	Statistikat Administrative mbi Pagat mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2014 dhe në vazhdim për: • Hendekun gjinor të pagës mesatar mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grupo-profesioneve; • Pagën mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grupo-profesioneve dhe gjinisë. Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2014 dhe në vazhdim për: • Hendekun gjinor të pagës mesatar mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike; • Pagën mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Në Statistikat e Pagës njësia matëse është në numër, përqindje dhe lekë.

5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Periudha e referencës për të dhënat Administrative mbi Pagat është 31 Dhjetor 2024. Ky raport i referohet vitit 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore në nivel kombëtar • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026 • Memorandum i bashkëpunimit i hartuar me institucionet e tjera.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat Administrative mbi Pagat nuk transmetohen në EUROSTAT. Aktualisht, INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me punësimin dhe papunësinë e regjistruar, të tilla si: EUROSTAT, ILO etj.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen reptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", si dhe Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to dhe ato të ngarkuar të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të

	përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për kërkuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore. Të dhënat e publikuara janë në nivel të përgjithshëm, nuk publikohen të dhëna individuale.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses në kalendarin e publikimeve	Kalendar i publikimeve mund të aksesohet online në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Seksioni Kërkesa të dhënash.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Të dhënat Administrative mbi Pagat janë publikuar në faqen e Web-it të INSTAT me një periodicitet tremujor dhe vjetor.
10. Akses në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftim për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të Statistikave Administrative mbi Pagat si: paga mesatare mujore, paga minimale mujore, ndryshimi i pagës reale etj. Njoftimi për shtyp i Statistikave Administrative mbi Pagat publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet për Statistikat Administrative mbi Pagat gjenden të botuara në botimet: “Të Dhënat Administrative mbi Pagat “ dhe “Tregu i Punës”. • Të Dhënat Administrative mbi Pagat • Tregu i Punës Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT

10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat për Statistikat Administrative mbi Pagat janë të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT, seksioni Databaza Statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat Administrative mbi Pagat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi Statistikat Administrative mbi Pagat.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Statistikave të Tregut të Punës dokumenton gjithë procesin e punës dhe procedurat e Statistikave Administrative mbi Pagat për qëllimet e brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" , INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: përgjegjëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vlefshmëria e të dhënave janë veprime që kryen gjatë gjithë procesit. Stafit i përfshirë në fazat e ndryshme të përpilimit të indikatorit, - të kështu si mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare që shoqërojnë përlogaritjen e indikatorit, - është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur. Kjo i jep mundësinë stafit që të përftojë një pamje të plotë dhe të vijimësi rreth ndërmarrjeve dhe përgjegjësisë të tyre. Burimi i të dhënave për Statistikat mbi Pagat është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e Statistikave të Pagave klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm.

	Përdoruesit e jashtëm janë: • Institucionet e Administratës Publike; • Universitetet; • Bizneset; • Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; • Organizata kombëtare jofitimprurëse. Përdoruesit e brendshëm janë drejtoritë prodhuese të INSTAT të cilat përdorin Statistikat e Pagave si input për punën e tyre.				
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit publikohen në web në linkun: Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve Rezultatet e vërtimit për 2024 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës " Të dhënat Administrative mbi Pagat " është vlerësuar me 3.79 (75.8 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).				
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për Statistikat e Pagave për vitin 2024 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026. Shkalla e Plotshmërisë të Statistikave të Pagave për 2024 është 100 %.				
13. Saktësia dhe besueshmëria					
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.				
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.				
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabimi të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.				
14. Afatet kohore dhe përpikmëria					
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e Statistikave të Pagave publikohen në faqen e internetit të INSTAT 70 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 70 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Pagave është data 31 Dhjetor 2024. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>3/11/2025</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e publikimit	3/11/2025
Periudha referuese	12/31/2024				
Data e publikimit	3/11/2025				

	Afatet kohore	70								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat Administrative mbi Pagat publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Pagave ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table><tr><td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr><tr><td>Data e shpallur</td><td>3/11/2025</td></tr><tr><td>Data e publikimit</td><td>3/11/2025</td></tr><tr><td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr></table>		Periudha referuese	12/31/2024	Data e shpallur	3/11/2025	Data e publikimit	3/11/2025	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2024									
Data e shpallur	3/11/2025									
Data e publikimit	3/11/2025									
Vonesa në kohë	0									
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria										
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Statistikat e Pagave paraqiten në nivel vendi. Këto statistika janë relativisht të krahaseshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.									
15.2. Krahaseshmëria kohore	Të dhënat Administrative mbi Pagat e të punësuarve të regjistruar në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve, datojnë që nga viti 2014 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahaseshmëri kohore prej 11 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=11). Të dhënat Administrative mbi Pagat e të punësuarve të regjistruar sipas aktivitetit ekonomik sipas NVE Rev.2 datojnë që nga viti 2014 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahaseshmëri kohore prej 11 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=11). Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahaseshmërinë e tyre në seri kohore.									
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.									
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.									
16. Kostoja dhe ngarkesa										
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Të dhënat e statistikave të pagave sigurohen nga burime administrative në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrat Statistikore Rajonale.									
17. Rishikimi i të dhënave										
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve									

17.2. Praktika e rishikimit	Në rast burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Pagave do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e radhës, shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit. Nuk janë kryer rishikime mbi “Të dhënat Administrative mbi Pagat” për vitin 2024, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Informacioni mbi Statistikat e Pagave grumbullohet nga burimet administrative në kuadër të Memorandumeve të bashkëpunimit, përkatësisht me: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të gjithë individët e regjistruar në formularin e Listëpagesës;
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Statistikave të Pagave grumbullohen prej burimeve administrative në baza tremujore dhe vjetore, me detajime mujore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Pagave për vitin 2024, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	